Nr 2716/2 Prot
Dt 04.11.2021

**PROCES VERBAL**

Mbajtur sot me datë: 04.11.2021, ora 13:00 në Njësinë Administrative Gurrë, për hartimin e projekt- buxhetit 2022 dhe Paketës Fiskale 2022.

Morrin pjesë Kryetari i Bashkisë, Nënkryetarja, koordinatorja për konsultimin publik, Përgjegjësja e Sektorit të Financës, Administratori i Njësisë & banorët.
Hap dëgjesën publike Adm. i Njësisë duke falenderuar pjesëmarrësit & duke treguar arsyen pse jemi mbledhur.
Merr fjalën Kryetari i Bashkisë i cili falenderon pjesëmarrësit & tregon që në bazë të ligjit për Vetqeverisjen Vendore jemi mbledhur për të mbledhur kërkesat e nevojat & për t'i paraqitur në buxhetin e vitit 2022.
Tregon që me buxhetin e Bashkisë nuk mund të realizohen investime të mëdha, por që do të bëjmë kërkesa te Ministritë e linjës apo te FSHZH.
Kryetari shpreh që nevojat jonë janë të mëdha në të gjithë Njësinë & në të gjithë Bashkinë.
Tregon që për vitin 2021 është marrë shumë me zgjidhjen e konflikteve.
Gjithashtu u bën me dije banorëve që jemi në proces të projektit të Urës së Domit & që presim financim nga Ministria.
U kërkon banorëve që të paraqesin problematikat.
Merr fjalën Agim Heti (Gurrë e Madhe) - falenderon pjesëmarrësit & ka kërkesë për kanalin e ujit vaditës, 1.5 km duhen bërë me beton.
Në lidhje ujin e pijshëm shprehet që të gjitha pusetat kërkojnë ndërhyrje dhe depo kryesore është pa çelës.
Gjithashtu shpreh kërkesë për hapjen e rrugës te Kodra.
Flet Liman Koçi: Falenderon pjesëmarrësit & uron sukses të mëtejshme.
Gjithashtu shpreh kërkesën për urën e Domit.
Merr fjalën Limon Baku (Rripë)
- Kërkon ndërhyrje te lidhjet e paligjshme në ujësjellës.
- Kërkon ndërhyrje në kanalin vaditës, projektin

& financimin.
Kërkon që të shtrohen rrugët me zhavor.
Merr fjalën Rexhep Ahmati (Gurrë e Vogël).
Ka ankesë për prerjen pa kriter të pyjeve &
tregon që duhet menaxhuar uji i pijshëm.
Fitim Collami (Gurrë e Vogël) tregon që problemi
është uji i pijshëm, duhen 200 m tub.
Flet Met Kurti: Tregon që problem është uji i
pijshëm & rruga.
Merr fjalën një banor i fisit Duka & shpreh
që duhen shtruar 400 m rrugë.
Flet nëna e Gjon Dukës: Tregon që problem është
uji vaditës.
Gjithashtu tregon që po shembet toka & ka
nevojë për ndërhyrje me beton.
Tregon që problemi është uji vaditës.
Flet Qemal Kurti: Falenderon pjesëmarrësit,
& tregon që problematikë është prerja pa kriter
e pyjeve, si dhe rrugët.
Flet Ibrahim Elezi (Kryetar fshati)
Falenderon për rrugën te Koci.
Ka nevojë për tub te lagjia Hajdini, për tub
vaditës.
Problematikë mbeten pyjet, prerja pa kriter e tyre.
Jusuf Kadiu, banor i fshatit Shullbatër,
shpreh kërkesën për ujë të pijshëm në fshatin
Shullbatër.
Kryetari: Është bërë projekti, pritet investimi.
Flet Adriatik Leci i cili falenderon pjesëmarrësit,
dhe për punën që è bërë me shkollat.
Thotë që duhet të jemi bashkëpunues.
Flet Besim Elezi: Ka kërkesë për rrugën e
Malit të Lenit (te Uva) e tregon që problem
janë tubimet.

Përgjegjëse e Financës

Silvana Bala

Koordinatore për Konsultimin Publik

Matilda Lleshaj